REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Sektori Juridik

Nr 4894 prot. Ballsh më, 18.09.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 53 Datë 18/09/2026

PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP) DHE BASHKISË MALLAKASTËR PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT : ASKUSH TË MOS MBETET PAS

Mbështetur në nenin 9, pika 1.2, shkronja "b", të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit me nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e SHqipërisë", i ndryshuar, Draft Marrëveshjes ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Mallakastër për zbatimin e projektit "Askush të mos mbetet pas" dhe anekseve përkatëse, VKM nr. 823, datë 06.12.2006 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat ditore"

PROPOZOJ

I. Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Mallakastër për zbatimin e projektit "Askush të mos mbetet pas".

II. Ky projekt vendim shoqërohet me draf marrëveshjen (me ankekset përkatëse) dhe relacion bashkëlidhur.

Konceptoi: Juristi, A.Heqimaj
Pranoi: Përgj, N.Sakaj
Miratoi: Drejtor M.Shehaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALLAKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E INTEGRIMIT EVROPIAN

Nr. 4894/1 prot. Ballsh, më 18.09.2026

RELACION MBI PROJEKT VENDIMIN
PËR MIRATIMIN E LETRËS SË MARRËVESHJES ("LM") NDËRMJET PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP) DHE BASHKISË MALLAKASTËR PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "ASKUSH TE MOS MBETET PAS" KU UNDP SHËRBEN SI PARTNER ZBATUES

Projekt –Vendimi i Bashkisë Mallakastër hartohet në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeversjen Vendore ", i ndryshuar, me nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë , Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për të Moshuarit në qendrat ditore, të miratuara me VKM nr. 823, datë 06.12.2006 , Zbatimin e projektit ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Mallakastër me objekt: Askush të mos mbetet pas".

Referuar konsultimeve midis zyrtarëve të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim ("UNDP") në Shqipëri dhe zyrtarëve të Bashkisë Mallakaster ("Pala Përgjegjëse") në lidhje me zbatimin e projektit nr. 01005254, "Askush të mos mbetet pas", Bashkia Mallakastër do të jetë plotësisht përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, në përputhje me kalendarin e përcaktuar të aktiviteteve dhe në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj LM.

Titulli i projektit: "Shërbime me bazë komunitare për të moshuarit"

Qëllimi: Përmirësimi i cilësisë së jetës së të moshuarve dhe rritja e përfshirjes së tyre sociale në komunitet.

Përshkrimi i shkurtër

Projekti "Shërbime me bazë komunitare për të moshuarit" synon ngritjen e një qendre ditore komunitare për të moshuarit në Bashkinë Mallakastër, me qëllim përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe rritjen e përfshirjes sociale. Qendra do të ofrojë një mjedis të sigurt dhe miqësor ku të moshuarit mund të kalojnë kohën e lirë, të socializohen dhe të marrin shërbime bazë socio-shëndetësore.

Qendra do të menaxhohet nga Bashkia Mallakastër dhe do të ketë si staf një punonjës social dhe një punonjës shërbimi. Në ambientet e saj do të ofrohen aktivitete sociale dhe argëtuese, si leximi i shtypit ditor, lojëra sociale (shah, domino, letra), si dhe organizimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese në bashkëpunim me institucione lokale.

Qendra do të ketë kapacitet për 30 persona të moshuar. Bashkia do të vërë në dispozicion ambientet, të cilat do të rehabilitohen dhe pajisen me mobilje dhe mjete të nevojshme.

P / Njësisë së Integrimit Europian
Mirjeta Shehaj

P / Sektori Çeshtjeve Sociale
Kleidja Hoxhaj

Drejtor i Burimeve Njerëzore
Marjola Shehaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR